

DETYRIMET E AZHBR

- Të publikojë në web “FTESË” për regjistrimin në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) së bashku me “Manuali i përdorimit të Sistemit PRDB”.
- Të vlerësojë dokumentet e subjekteve për regjistrim në Sistemin elektronik të Bazës së të Dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) dhe të njoftojë subjektet për vendimin e marrë.
- Të vlerësojë e të regjistrojë çmimet/ofertat e dërguar nga subjektet në Sistemin elektronik të Bazës së të Dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) dhe të njoftojë subjektet në rast se informacioni nuk regjistrohet duke argumentuar nëse informacioni ka nevojë për plotësime/shpjegime ose kur informacioni është i parregullt.
- Të pajis subjektet “e paregjistruara”, të cilët kanë dërguar informacionin me e-mail ose postë të thjeshtë, me kredenciale “emri përdoruesit” dhe “fjalëkalim” për aksesimin e sistemit elektronik të PRDB.
- Sipas rastit, të dërgojë me e-mail “Kërkesë për ofertë” për zëra/asete për të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme në Sistemin elektronik të Bazës së të Dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB).
- Të ruaj konfidencialitetin e informacionit financiar dhe administrative të dërguar nga subjektet.
- Të jap shpjegime subjekteve lidhur me procedurat apo specifikimet teknike për zëra/asete të veçanta sipas kërkesës së tyre të dërguara me e-mail.
- Të ofrojë suport teknik për përdoruesit e Sistemit elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) nëpërmjet numrit jeshil 0800 83 83.
- Të reklamojë në webin www.azhbr.gov.al emrat e subjekteve dhe fushat e aktivitetit të tyre për subjektet të cilat plotësojnë këto kritere:
 - Të jetë i regjistruar në QKB, për subjektet që zhvillojnë aktivitetin brenda territorit të Shqipërisë, ose regjistruar në organet kompetente sipas legjislacionit të vendit ku zhvillojnë aktivitetin jashtë territorit të Shqipërisë.
 - Të regjistrojë në Sistemin PRDB çmime/oferta ose ti dërgojë me email ose postë të thjeshtë në AZHBR për investime, fusha e të cilëve, janë të parashikuara në Ekstraktin e QKB në seksionin “Objekti i aktivitetit”/”Regjistri Firmës”.
 - Çmimet/Ofertat të jenë pa TVSH dhe të kenë vlefshmëri jo më pak se 1 (një) vit nga data e regjistrimit/dërgimit në AZHBR.